



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201900519/22

Tiranë ____/____/2019

Lënda: *Rekomandohet zbatimi i parimit ligjor të proporcionalitetit kur përdoret gazi lotsjellës nga punonjësit e policisë (rasti i banorëve të "Bregut të Lumit")*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT

Drejtorit të Përgjithshëm
Drejtues Madhor, Ardi Veliu

TIRANË

I nderuar Z. Veliu,

Institucioni i Avokatit të Popullit ndërmori një hetim administrativ lidhur me lajmin e bërë publik në media se, Policia e Shtetit kishte përdorur në kundërshtim me ligjin gaz lotsjellës gjatë operacionit të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Tiranë për shembjen e banesave në zonën e njohur me emrin "Bregu i lumit", në Tiranë. Sipas banorëve që kanë protestuar kundër shembjes së banesave të tyre, punonjësit të policisë kanë hedhur gaz lotsjellës në mjedise të mbyllura, ndërkohë që brenda banesave ka patur persona, ndër to edhe fëmijë të mitur.

Lajmi është bërë publik në dt. 9 Prill 2019, kur Policia e Shtetit ka mbështetur Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, për të ekzekutuar vendimet për prishjen e objekteve, të cilat preken nga projekti urbanistik: "Bulevardi Verior dhe rehabilitimi i Lumit të Tiranës".

Për verifikimin e ankesave të ngritura nga banorët, kemi kërkuar informacion dhe dokumentacion nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Sipas dokumentacionit të administruar, Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, me shkresën Nr.14751 Prot., datë 04.04.2019, i ka kërkuar Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, Komisarariatit të Policisë Nr.4 dhe disa institucioneve të tjera të marrin masa për të mbështetur ndërhyrjen tek Bulevardi i Ri Verior i Tiranës në datat 8-9 prill 2019, në zbatim të projektit "Bulevardi Verior dhe rehabilitimi i Lumit të Tiranës". Në mbështetje të IMT Bashkia Tiranë, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë ka

hartuar planin e masave që i është dërguar disa strukturave të Policisë së Shtetit me shkresën Nr.3444 Prot., dt. 04.04.2019.

Ndërsa, në përgjigjen e marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me shkresën Nr.3860/1 prot., dt. 15.05.2019 thuhet se:

“Nuk janë hedhur fishekë/granata me gaz lotsjellës në mjedise të mbyllura, por në terracën e një banese të boshatisur, e cila ishte planifikuar të prishej. Përdorimi i lëndëve lotsjellëse është diktuar nga fakti që mbi terracë qëndronin rreth 20 persona, të cilët godisnin me gurë dhe sende të forta punonjësit e policisë. Si rezultat i goditjeve janë dëmtuar lehtë punonjës policie, janë thyer mburoja dhe skafandra mbrojtëse. Drejtuesit e operacionit janë këshilluar me specialistët, ndihmësit dhe përdoruesit e lëndëve lakrimogjene, të cilët janë punonjës të trajnuar në përdorimin e pajisjeve dhe municionit lakrimogjen. Para përdorimit të këtyre lëndëve, është bërë vlerësimi i situatës dhe strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë kanë informuar punonjësit e Ndërhyrjes së Shpejtë se në banesën ku kishin hipur personat që qëllonin me gurë dhe në ato përreth nuk kishte banorë brenda”.

Për të analizuar nëse veprimet e punonjësve të policisë janë kryer ose jo në përputhje me ligjin dhe nëse është zbatuar parimi ligjor i proporcionalitetit kur përdoren lëndë lakrimogjene, i referohemi akteve normative që rregullojnë veprimtarinë e tyre.

Në Ligjin Nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, nenet 99 dhe 133 parashikohet se:
Neni 99

“1. Punonjësi i policisë ka të drejtë të mbajë armë. Llojet e armatimit, të lëndëve neuroparalizuese dhe të mjeteve të tjera të përdorimit të forcës nga policia përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Punonjësit të policisë i jepen në përdorim mjete dhe pajisje të tjera nga ato të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, të përcaktuara në Rregulloren e Policisë”.

Neni 133

“1. Punonjësi i policisë përdor forcën për të përmbushur detyrën vetëm kur kjo është e nevojshme dhe vetëm nëse të gjitha masat e tjera janë të pasuksesshme apo të pamundura.

2. Punonjësi i policisë përdor forcën në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

3. Punonjësi i policisë përzgjedh nivelin e nevojshëm të forcës ndërmjet mundësive të përshkallëzuara, që, ndër të tjera, përfshijnë bindje me fjalë, shtrëngim fizik, mjete goditëse, mjete me lëndë paralizuese, mjete me goditje elektrike, qen policie dhe armë zjarri.

4. Të dëmtuarit i jepet ndihmë, ku përfshihet edhe ajo mjekësore, pas përdorimit të forcës, në rast se kjo është e nevojshme dhe e mundur.

5. Punonjësi i policisë duhet të paralajmërojë se do të përdorë forcën para përdorimit të saj. Ky paralajmërim mund të mos kryhet nëse rrethanat nuk e lejojnë, veçanërisht kur përdorimi i menjëhershëm i forcës është i nevojshëm për të parandaluar një rrezik real dhe të çastit.

6. Grupe personash paralajmërohen sa më shpejt të jetë e mundur se do të përdoret forcë ose forma e forcës së përdorur do të ndryshohet, në mënyrë që pjesëmarrësit të lejohen të largohen”.

Ndërsa, në VKM Nr.750, dt.16.09.2015 “Për miratimin e rregullores së Policisë së Shtetit”, nenet 54/1 dhe 110 parashikohet se:

Neni 54

“1. Punonjësit e Policisë pajisen me armatim, municion e pajisje për kryerjen e detyrave të ngarkuara, sipas funksionit organik, në përputhje me ligjin "Për armët".

Neni 110

“1. Punonjësi i Policisë përdor forcën vetëm kur është në mënyrë të arsyeshme e nevojshme dhe vetëm në masën që kërkohet për të arritur një synim të ligjshëm.

2. Punonjësi i Policisë, në çdo rast e përdor forcën pa cenuar thelbin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe përdor gjithmonë mjete të përshtatshme në proporcion me rrezikun dhe qëllimet që synohen të arrihen.

3. Punonjësi i Policisë është përgjegjës individualisht për ushtrimin e forcës dhe jep llogari para ligjit”.

Llojet e armatimit, lëndët neuroparalizuese dhe mjete të tjera të përdorimit të forcës nga strukturat e Policisë së Shtetit, janë të miratuara me VKM Nr.293, dt. 08.04.2015 “Për miratimin e llojeve të armatimit, të lëndëve neuroparalizuese dhe të mejeteve të tjera të përdorimit të forcës nga Policia e Shtetit”, sipas lidhjes që i është bashkëlidhur këtij vendimi. Më konkretisht, në pikën 2/b parashikohet se strukturat e Policisë së Shtetit pajisen me:

“Municione me lëndë irrituese në formë pluhuri, lëngu me përbërje CS; CN; OC; që hidhen me shotgun, me granatë dore, pajisje hedhëse, sprajt ose tubet, për mbrojtjen, menaxhimin dhe kontrollin e turmave”.

Sa i përket procedurës së përdorimit të lëndëve lakrimogjene, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, me Urdhërin Nr.92, dt. 06.02.2015 ka miratuar Procedurën standarte “Për përdorimin e lëndëve lakrimogjene”, në pikën II të së cilës thuhet se:

“Kjo procedurë përcakton se lëndët lakrimogjene do të përdoren nga strukturat e policisë për vetëmbrojtje, në operacione policore për kapjen e personave të rrezikshëm e të armatosur që qëndrojnë në vende të mbyllura, për shpërndarje turmash të dhunshme, për neutralizimin e veprimeve të subjekteve kriminale

Pavarësisht se lëndët lakrimogjene janë jo vdekjeprurëse, punonjësit e policisë do t'i përdorin në masë të tillë që niveli i dëmtimeve të jetë sa më i vogël për jetën dhe shëndetin e personave që janë nën ndikimin e efektit të lëndëve”.

Në pikën IV/A/6 të Procedurës përcaktohet se:

“Drejtuesi i operacionit kur gjykon se duhet të përdoret lëndë lakrimogjene paraprakisht këshillohet me specialistin e përdorimit për sasinë e lëndës që duhet përdorur, kushtet meteorologjike, drejtimin e erës, objektet që janë më të rëndësishme ku duhet shmangur afrimi i turmës së dhunshme, vendet e rrezikshme ku nga përdorimi i lëndëve lakrimogjene mund të shkaktohen zjarre, rrugët e evakuimit etj”.

Sjellim në vëmendje se në pikën IV/C të Procedurës parashikohet përdorimi i lëndëve lakrimogjene për shpërndarjen, zhvendosjen e turmave të dhunshme në ambiente të hapura (sheshe, rrugë), gjysëm të hapura (stadium, terrene sportive të mbuluara) dhe të mbyllura (ndërtesa, shpella etj.). Më konkretisht, në pikën 1 të shkronjës C parashikohet se:

“Përdorimi i lëndëve lakrimogjene bëhet vetëm me urdhër të drejtuesit të operacionit pasi janë konsumuar të gjitha masat paraprake dhe përdorimi i lëndëve lakrimogjene mbetet një mundësi për arritjen e qëllimit të planit operacional të miratuar, ose kur rrethanat ndryshojnë papritur dhe përdorimi i lëndëve lakrimogjene frenon rritjen e veprimeve të dhunshme ndaj forcave të policisë apo arratisjen e personit të rrethuar”.

Një rëndësi të veçantë në mbështetjen institucionale që Policia e Shtetit u jep institucioneve të tjera, është dhe zbatimi i Procedurës standarte *“Për bashkëpunimin dhe mbështetjen institucionale që Policia e Shtetit i jep institucioneve të tjera shtetërore”*, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, me Urdhrin Nr.255, dt.15.03.2017.

Në pikën I, III/A/6 dhe B/3/4 të Procedurës thuhet:

Pika I

“Strukturat e Policisë së Shtetit, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitutional dhe në bazë të aktmarrëveshjeve të përbashkëta me organet/institucionet e tjera shtetërore, ndihmojnë dhe mbështetjen këto institucione për zbatimin e akteve ligjore, në rastet kur ka arsye të mjaftueshme për të besuar se ndaj përfaqësuesve të tyre mund të ushtrohet dhunë”

Pika III/A/6

“Drejtuesit e Drejtorisë Vendore të Policisë/ Komisarariatit Vendorë të Policisë në bazë të informacioneve të marra, përcaktojnë e vlerësojnë shkallën e rrezikshmërisë që mund të paraqitet gjatë procesit të ndihmës/mbështetjes së organeve/institucioneve shtetërore dhe mbi këtë bazë planifikojnë personelin, mjetet, pajisjet dhe mbështetjen teknike të nevojshme për të realizuar bashkëpunimin e dhënien e mbështetjes ndaj institucionit përkatës shtetëror”.

Pika B/3/4

“3. Punonjësit e policisë të ngarkuar me detyrë për realizimin e mbështetjes të institucionit/institucioneve të tjera shtetërore marrin masa për parandalimin e çdo veprimi apo reagimi të personave të tjerë, ndaj personave përfaqësues të organeve dhe institucioneve shtetërore, të cilët janë të detyruar të përmbushin detyrat e tyre ligjore.

4. Punonjësit e policisë duhet të paralajmërojnë personin/personat që ju bëjnë rezistencë veprimeve ligjore të përfaqësuesve të organeve dhe institucioneve të tjera shtetërore, se në rast se nuk ndërpresin rezistencën, do të përdoret forca për të mposhtur rezistencën e tyre”.

Pra, legjislacioni e lejon përdorimin e lëndëve lotsjellëse nga Policia e Shtetit, edhe në mjedise të mbyllura apo gjysëm të hapura, por pasi janë konsumuar të gjitha masat paraprake dhe përdorimi i lëndëve lakrimogjene mbetet një mundësi për arritjen e qëllimit të planit operacional të miratuar ose kur rrethanat ndryshojnë papritur dhe përdorimi i lëndëve lakrimogjene frenon rritjen e veprimeve të dhunshme ndaj forcave të policisë. Mjetet e forcës që disponon Policia e Shtetit përdoren edhe në rastet kur mbështeten institucione të tjera për zbatimin e akteve ligjore, nëse ndaj tyre bëhet rezistencë. Gazi lotsjellës është përdorur gjatë operacionit të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit,

Bashkia Tiranë për prishjen e disa banesave të “Bregu i Lumit”, vetëm në dt. 9 Prill 2019, pasi në këtë datë dhe një ditë më parë, ndaj punonjësve të policisë është bërë rezistencë dhe janë hedhur sende të forta.

Por, a është respektuar parimi i proporcionalitetit nga punonjësit e Policisë së Shtetit në këtë rast?

Vlerësojmë se, në rastin e banorëve të “Bregut të Lumit”, nuk është zbatuar parimi i proporcionalitetit kur është përdorur gazi lotsjellës. Në përgjigjen Tuaj thuhet se, para përdorimit të këtyre lëndëve, është bërë vlerësimi i situatës dhe strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë kanë informuar punonjësit e Ndërhyrjes së Shpejtë se në banesën ku kishin hipur personat që qëllonin me gurë dhe në ato përreth nuk kishte banorë brenda. Si mund të ishte i sigurt ky informacion, kur nuk ishte e mundur për punonjësit e policisë t’i afroreshin banesave për shkak se disa banorë e bënë këtë të pamundur, pasi po godisnin me gurë?

Edhe nëse do të pranojmë që fisheku/granata e gazit lotsjellës është hedhur me precision në terracën e banesës ku qëndronin persona që qëllonin me gurë punonjës të policisë, është e pashmangshme që gazi të mos shpërndahet në mjedise të mbyllura apo gjysëm të hapura, sidomos kur kemi të bëjmë me dendësi banesash.

Nga ana e punonjësve të policisë duhet të ishte këmbëngulur në përdorimin e masave të tjera për të bindur banorët që të ndërprisnin rezistencën. Gazi lotsjellës është përdorur edhe në operacionin të zona e “Astirit”, për të bërë të mundur prishjen e banesave. Në të gjitha situatat duhet të kihet parasysh se, përdorimi i gazit përbën një rrezik të shtuar për jetën dhe shëndetin e banorëve. Siç dëshmuam rrëfimet e banorëve të zonës së “Astirit” dhe pamjet e publikuara në media, që dokumentuan operacionin gjatë të cilit u përdor gaz lotsjellës, mundësia për tu larguar nga një mjedis i mbyllur, i mbushur me gaz, është e pakët, veçanërisht për personat vulnerabël.

Edhe personat që gjenden në terracë apo çati, siç ndodhi gjatë operacionit të “Bregu i Lumit”, e kanë të vështirë të orientohen nën efektin e gazit dhe me shikueshmëri të dobët, për të gjetur një rrugë të sigurtë largimi. Gjetja e personave të dëmtuar dhe ardhja në ndihmë nga ekipet mjekësore, në një zonë me dendësi banesash, mund të bëhet me vonesë.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut”* si dhe në mbështetje të nenit 21/b të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”*

REKOMANDOJMË:

- Zbatimi i parimit ligjor të proporcionalitetit kur përdoret gazi lotsjellës nga punonjës të policisë;
- Analizimin e këtij rasti në strukturat përgjegjëse për përdorimin e gazit lotsjellës dhe në Drejtorinë Vendore të Policisë.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi